




Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



**PROCESVERBAL I
KONSULTIMIT PUBLIK
PËR DRAFT VLERËSIMIN
STRATEGJIK MJEDISOR
(VSM) PËR HARTËN
ZONALE KOMUNALE TË
RAHOVECIT 2024-2032**

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Komuna e Rahovecit, për përgatitjen e Draft Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale Komunale të Rahovecit 2024-2032, duke u bazuar në Ligjin numër 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe Nenit 6, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, bën njoftimin për:

KONSULTIM PUBLIK

Me 22.12.2023 është publikuar njoftimi për mbajtjen e Konsultimit për **Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale Komunale të Rahovecit 2024-2032**. Njoftimi është publikuar në webfaqen zyrtare të Komunës, facebookun e komunës dhe Platformën e Konsultimeve Publike, përmes rrjetit social viber janë njoftuar qytetarët.

1. Publikimi në webfaqe: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/12/NJOFTIM-PUBLIK-Lidhur-me-organizimin-e-konsultimit-publik-me-qytetare-per-Draft-Vleresimin-Strategjik-Mjedisor-VSM-per-Harten-Zonale-Komunale-te-Rahovecit-2024-2032-1.pdf>
2. Publikimi facebook: <https://www.facebook.com/share/p/LuAwb5fStdoiDYrF/?mibextid=vo1riV>
3. Publikimi në Platformën e Konsultimeve Publike: <http://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42057>

KONSULTIMI PUBLIK

Më datë: **5.1.2024** mbahet konsultimi publik në sallën e Kuvendit Komunal. Të pranishëm kanë qenë zyrtarë komunal, kryetarët e këshillave të fshatrave, dëshmi janë listat e nënshkrimeve.

Lajmin për mbajtjen e konsultimin mund të gjeni të publikuar në vegëzën: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/news/mbahet-konsultimi-publik-per-draft-vleresimin-strategjik-mjedisor-vsm-per-harten-zonale-komunale-te-rahovecit-2024-2032/>

Konsultimi publik filloi në orën 10:00.

Konsultimin e shpalli të hapur, **Albnor Mullabazi, drejtor i Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtje të Mjedisit**, njëherit menaxher i projektit. Falenderoi përfaqësuesit nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor, departamentin e Mjedisit, z.Riza Muqolli dhe z.Perparim Herziu.

Pas miratimit të Planit Zhvillimor Komunal është hapur rruga që të vazhdojmë edhe me Hartën Zonale Komunale. Vlerësimi Strategjik Komunal është një nga instrumentet kryesore për integrimin e shqetësimeve për aspektin mjedisor dhe të parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikim dhe vendimarrje strategjike. Vlerësimi Strategjik Mjedisor mundëson një proces sistematik dhe paraprak që të ndermirren me qellim që analizimit të efekteve mjedisore të të gjitha planeve të cilat kanë të bëjnë me Komunën e Rahovecit. Qëllimi i VSM mund të përcaktohet si garantim i informatave të vendimarrjes strategjike nga aspekti mjedisor dhe integrimi i këtyre të fundit për të përkrahur zhvillimin e qëndrueshëm në aspektin mjedisor.

Ky dokument është në konsultim publik prej 22.12.2023 deri me 22.01.2024, për prezantim më të detajuar të draft dokumentit do ta bëjë Valoni.

Valon Gërmizaj ka bërë prezantimin e planit. Fillimisht ka falënderuar drejtorin për bashkëpunimin e mirëfilltë. Në këtë dokument kanë punuar edhe shumë eksper të tjer të licensuar.

Diskutimi sot nuk ka të bëjë me prezentimin e hartës zonale si të tillë, nuk mund të ju japim përgjigje në lidhje me planifikimin e hartës zonale. Ky konsultim është një periudh prej 30 ditëve

i cili është obligativ në mënyrë që me i hap rrugë shqyrtimit vijues të hartës zonale të komunës, ku pastaj do të jetë subjekt i trajtimit vetem harta zonale e komunës. Ky është vetem një hap ligjor të cilën komuna e ka ndërmarr për hapjen e rrugës të hartës zonale të komunës.

VSM është një proces që synon integrimin e komenteve, në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe politikave, si i tillë harta zonale e komunës është një lloj plani i cili parasheh zhvillimin e ardhshëm të komunës përmes kushteve zhvillimore dhe masave mbrojtëse për 8 vitet e ardhshme. Qëllimi i këtij raporti është që të bëjë identifikimin, përshkrimin të ndikimeve të mundshme që do ta cenojnë dhe kërcënojnë mjedisin dhe përshkrimin e vlerësimit të identifikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i këtij dokumenti. Përpos vlerësimit ky dokument jep edhe rekomandime të cilat duhet ti përfill komuna në të ardhmen kur të përgatis hartën zonale të komunës dhe që ti zbatojë ato pas miratimit të hartës zonale.

Metodologjia e ndjekur burimin e saj e ka në përputhje me direktiven e BE-së, që ka të bëjë me vlerësimin e efekteve të disa planeve në mjedis, gjithashtu është e bazuar edhe në ligjin për vlerësimin mjedisor që është një përfshirje e legjisllacionit në BE. Harta Zonale e komunës për numrin e madh dhe diversitetin e gjerë të problematikes që trajton kërkon edhe konsultimin ligjor.

Ky dokument, përpos materialeve janë marr edhe disa kërkime si strategjit e ndryshme të nivelit qendror. Qëllimi është që zhvillimet e ardhshme të jenë në harmoni me legjisllacionin vendor të mjedisit dhe konventat e ndryshme. Përshkrimet dhe ndikimet e mundshme të konsiderueshme në mjedis, nuk është vetem shëndeti publik i njerzve, por gjithashtu është edhe shëndeti publik i flores dhe faunes, biodiversitetit, tokës, klimes, ajrit, ujit, zonave natyrore të cilat janë në mbrojtje, zonat e trashigimisë kulturore të cilat janë mbrojtje dhe nderveprimi i këtyre faktorëve çka është planifikuar një hart zonale mund të ketë ndikime pozitive dhe negative në njërin nga këto komponente mjedisore. Parqet solare ka interes të investimit nëpër komuna, këto ndikojnë në rritjen e cilësisë së ajrit, ndërsa ndokojnë negativisht në biodiversitet.

Përshkrimi i masave të parashikuara që duhet të parandalohen, reduktohen dhe lehtësohen sa i përket aspektit të ndikimeve ngative në mjedis, pastaj për zgjedhja e alternativave të shqyrtuara duke përfshirë vështirësitë e ndryshme gjatë përpilimit të raportit.

Flaka Dedaj: Përshëndetje te gjithëve, ne jemi mundu me i përfshi të gjithë komponentet që praktikisht obligohen me korniz ligjre.

Analiza Swot ku janë përfshirë zonat me probleme mjedisore ku janë bër diskutime me grupe të faktorëve, janë përcaktuar zonat të cilat kanë nevoj për mbrojtje mjedisore, ndër të cilat janë: Manastiri në Zoqisht dhe fshati Hoçë e Madhe, si zona të veçanta të mbrojtura në harmoni me ligjin.


Veçoritë natyrore kryesore të komunës, zonat që potencialisht mund të ndikohen. Zonimi i territorit të komunës së Rahovecit ndahet në:

- zonat e pazhvilluara me ndërtim;
- zonat turistike;
- zona të mbrojtura

Raporti përfundimtar është rezultati kryesor raportues i procesit të VSM-së. Pas shqyrtimeve dhe komenteve të komunës, si dhe seancave të dëgjimeve me publikun, do të shihen pyetjet, komentet dhe sugjerimet që dalin gjatë procesit.

Rekomandimet që kanë dale nga VSM-ja janë:

- Definimi në hartë i zonave me potenciale rrezatimi, por edhe planifikimi i mundësive për trajtimin e rrezatimit dhe uraniumit të varfëruar në vendet kë është goditur me bomba në luftën e fundit,
- Definimi në hartë i zname erozive dhe vërshimeve;
- Definimi i zonave industriale në aspektin hapsinor;
- Definimi me HZK I vendeve dhe mundësive për pyllëzim dhe ri-pyllëzim ;
- Definimi në HZK I zonave, vijave, ose pikave të ndotura nga mbeturinat;

- 
- Definimi dhe trajtimi i zonave conform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujrat nëntokësor dhe sipërfaqësor;
 - Definimi dhe rajtimi i korridoreve transportuese ;
 - Definimi i peisazheve, parqeve dhe monumenteve;
 - Trajtimi I ngrohjes së qytetit të Rahovecit;
 - Definimi dhe trajtimi I zonave të pasura me flore dhe faunë

Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj.

Konsultimi publik përfundoi në orën: 11:15.

FOTOGRAFITË DHE LISTA E NËNSHKRIMEVE





REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E RAHOVACIT / KOMUNË E RAHOVACIT
KRYETARI I KOMUNES / PREREDHEBENIKU POSTORNE / MUNICIPALITY
II
RAHOVEC
ORAHOVAC
Zyra për Informim